

UDHËZIM
Nr. 472, datë 19.11.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 385, DATË 13.10.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJEN E LICENCËS
PËR ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORIT,
RIPËRTËRITJEN E SAJ, SI DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE PËR PEZULLIMIN DHE HEQJEN E LICENCËS NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË
DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 35, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” bëhet ndryshimi, si më poshtë:

1. Në kreun I, germa d, pika 4, shtohen fjalët:

“Në çdo rast shtyrja e këtij afati do të bëhet me urdhër të ministrit të Kulturës dhe është i argumentuar”.

2. Ky ndryshim në udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të ministrisë së Kulturës, si dhe në Fletoren Zyrtare.

3. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij udhëzimi.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti